

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHIJA TONA kundër SHQIPËRISË**  
(Kërkesa nr. 78957/11)

**VENDIM**

STRASBURG

4 korrik 2024

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.*

**Në çështjen Tona kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *president,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 13 qershor 2024,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili miratohet po në atë datë:

**PROCEDURA**

1. Çështja vjen pas depozitimit në Gjykatë të një kërkesë kundër Shqipërisë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 1 dhjetor 2011.

2. Kërkuesi, z. Llazi Tona (për detaje dhe informacione të mëtejshme në lidhje me kërkesën, shihni tabelën bashkëngjitur) u përfaqësua nga znj. A. Theodhosi, avokate e licencuar në Tiranë. Më 3 janar 2018, z. Ferdinand Tona, trashëgimtari i kërkuetit, informoi Gjykatën për vdekjen e kërkuetit dhe shprehu dëshirën e tij për të vazhduar procesin në emër të kërkuetit. Gjykata nuk sheh asnjë pengesë që z. Ferdinand Tona, trashëgimtari i kërkuetit, të vazhdojë këtë kërkesë në emër të kërkuetit dhe pranon që z. Ferdinand Tona ka legjitimitet në këtë proces. Megjithatë, në këtë vendim, Gjykata do të vazhdojë t'i referohet z. Llazi Tona si "kërkueti".

3. Qeveria Shqiptare ("Qeveria") u njoftua për kërkesën.

**FAKTET**

**I. VENDIMET E BRENDSHME**

**A. Vendim 2006**

4. Më 4 korrik 2006, Komisioni i Pronave Korçë vendosi mbi kërkesën e kërkuetit për njohjen dhe kthimin e pronave të shtetëzuara në kohën e komunizmit ("Vendimi 2006").

5. Sipas klauzolës 1, Komisioni konstatoi që babai i kërkuetit kishte në pronësi një parcelë toke pyjore me përmasa 111.28 hektarë, e cila ishte shpronësuar gjatë periudhës së komunizmit.

6. Sipas klauzolës 2, Komisioni urdhëroi që parcela e mësipërme t'u kthehet kërkuetit dhe familjarëve të tij.

7. Sipas klauzolave 3 dhe 4, Komisioni rrëzoi pretendimet e kërkuetit në lidhje me dy parcela shtesë.

**B. Vendim 2008**

8. Në një datë të pacaktuar, kërkueti paditi shtetasin N.GJ. dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ("ZRPP"). Drejtoria e Pyjeve, e cila ishte përgjegjëse për parcelat pyjore objekt të mosmarrëveshjes u ftua si palë e tretë në proces. Kërkueti kundërshtoi vendimin e vitit 2006, duke pretenduar se Komisioni kishte refuzuar gabimisht pretendimin e tij për pronësinë, në lidhje me

parcelat e mbetura pyjore. Ai shtoi se në proceset paralele Komisioni kishte gabuar duke i njohur N.GJ. titullin e pronësisë mbi këto parcela.

9. Më 14 nëntor 2008, Gjykata e Rrethit Pogradec dha vendimin e saj për këtë çështje (“Vendimi 2008”). Ajo anuloi vendimin e Komisionit për konfirmimin e titullit të N.GJ. dhe urdhëroi që të paditurit të “njohin si pronar të parcelave, babanë e paditësit Llazi Tona, ish-pronarin Mitri Tona” të listuar në vendim (“*detyrimin e të paditurve ta njohin atin e paditësit Llazi Tona, ish-pronarin Mitri Tona[,] pronar mbi parcelat...*”).

10. Përveç kësaj, vendimi prishi klauzolat 2, 3 dhe 4 të vendimit të vitit 2006. Në mungesë të ankimit, ky vendim mori formë të prerë më 27 janar 2009.

11. Më 5 mars 2009, Gjykata e Rrethit Pogradec plotësoi vendimin e mësipërm, duke shtuar referencë për një raport ekspertize që përshkruante kufijtë e parcelave dhe vizatonte hartën. Raporti dhe harta i janë bashkëngjitur vendimit.

12. Më 10 qershor 2010, ZRPP-ja refuzoi regjistrimin e parcelave në fjalë në emrin e kërkuesit sipas vendimit të vitit 2006, i ndryshuar me vendimin e vitit 2008. Ajo u shpreh se sipas një rregulloreje të brendshme të ZRPP-së të datës 8 prill 1999, kërkuesi detyrohej të paraqiste një *procesverbal të dorëzimit fizik të pronës*, i cili tregonte se Drejtoria e Pyjeve, në fakt i kishte dorëzuar parcelat te kërkuesi. Sipas ZRPP-së, ky procesverbal duhej të hartohej nga një përmbarues.

## II. PROCEDURA E EKZEKUTIMIT

### A. Urdhra ekzekutimi

13. Më 30 dhjetor 2010, Gjykata e Rrethit Pogradec nxori një urdhër ekzekutimi, në lidhje me vendimin e vitit 2006, i ndryshuar me vendimin e vitit 2008.

14. Ajo konstatoi se ishte i domosdoshëm *lëshimi i urdhrit të ekzekutimit [...] “për kërkuesin për efekt të gëzimit dhe disponimit të pasurive të paluajtshme mbi të cilat ka fituar të drejtën reale të pronësisë”*.

Më tej, ajo vuri në dukje, se: “*pa u kryer regjistrimi [në ZRPP] kërkuesi [,] edhe pse pronar [,] nuk mund të tjetërsojë ose nuk mund të ketë disponim tjetër mbi sendet e paluajtshme”*.

15. Më 15 shtator 2010, Zyra e Avokatit të Shtetit iu përgjigj një kërkesë për orientim nga Ministria e Mjedisit dhe e informoi atë, se nuk ishte e qartë nëse vendimi i vitit 2006, i ndryshuar me vendimin e vitit 2008, përmbante vetëm konstatime deklarative që kërkuesi kishte në pronësi parcelat e pyjeve në fjalë apo përmbante, përveç kësaj, një urdhër për t’i kthyer kërkuesit ato parcela. Avokati i Shtetit, më tej, njoftoi që autoritetet duhet të refuzojnë dorëzimin e parcelave te kërkuesi.

### B. Ekzekutimi i detyruar

16. Më 2 qershor 2011, Zyra Përmbarimore Pogradec urdhëroi ZRPP-në të regjistronte parcelat në emrin e kërkuesit. Kjo e fundit refuzoi, sepse përmbaruesi nuk kishte dorëzuar *procesverbalin e dorëzimit fizik të pronës*.

17. Në një korrespondencë të mëvonshme me kërkuesin, përmbaruesi vuri në dukje se vendimet përfundimtare nuk i referoheshin dorëzimit të parcelave, prandaj detyrat e përmbaruesit kufizoheshin në transferimin e titullit të pronësisë të kërkuesit, pa adresuar çështjet e dorëzimit fizik të parcelave. Më 19 korrik 2011, Zyra Qendrore e Përmbarimit e konfirmoi këtë pikëpamje.

18. Me vendimin e datës 4 gusht 2011, përmbaruesi vëren se ZRPP-ja duhej t’i regjistronte parcelat në emrin e kërkuesit. Me këtë konstatim, përmbaruesi vlerëson se ekzekutimi kishte përfunduar dhe vendosi pushimin e procedimit.

19. Më 19 korrik 2012, ZRPP-ja iu përgjigj përmbaruesit dhe kërkuesit, duke kërkuar edhe një herë një kopje të procesverbalit të dorëzimit fizik, me qëllim regjistrimin e parcelave në emër të kërkuesit.

## LEGJISLACIONI

### I. SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1 TË NENIT 6 TË KONVENTËS

20. Kërkuesi u ankua për mosëkzekutimin e vendimit të vitit 2006 të ndryshuar nga vendimi i vitit 2008. Në thelb, ai u mbështet në paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës.

21. Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore”, për qëllime të paragrafit 1 të nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës gjyqësore në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, § 40, *Raporte të Vendimeve* 1997 II).

22. Në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 38–45, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 55–61, 29 shtator 2009), Gjykata tashmë ka gjetur shkelje në lidhje me probleme të ngjashme me ato në këtë çështje.

23. Gjykata fillimisht vëren se në vëzhgimet e saj fillestare, Qeveria parashtrori se autoritetet e brendshme kishin marrë çdo masë të mundshme për të zbatuar vendimet e brendshme. Megjithatë, Gjykata nuk është në gjendje të bjerë dakord, sepse autoritetet e brendshme as nuk i kanë regjistruar parcelat nën emrin e kërkuarit dhe as nuk kanë siguruar fizikisht transferimin e atyre parcelave tek ai.

24. Më tej, Qeveria parashtrori se kërkuari ishte bërë pengesë për zbatimin e vendimeve të brendshme përfundimtare, sepse ai nuk i kishte parapaguar Zyrës Përmbartimore Pogradec disa shuma të nevojshme për ekzekutimin e detyruar dhe kishte bërë një sërë kërkesash të paarsyeshme në lidhje me inventarizimin e pemëve në parcelat pyjore. Megjithatë, në dosjen e çështjes nuk ka asnjë të dhënë për ndonjë pengesë të krijuar nga kërkuari në procesin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare. Në veçanti, nuk rezulton se Zyra Përmbartimore Pogradec të ketë pushuar procedimin për shkak të ndonjë veprimi që i atribuohet kërkuarit (shihni paragrafin 18 më sipër).

25. Qeveria argumentoi, gjithashtu, se vendimet e brendshme përfundimtare në favor të kërkuarit kishin konfirmuar titullin e tij të ligjshëm mbi parcelat, por nuk ishte e qartë nëse gjykatat vendëse kishin urdhëruar, gjithashtu, që parcelat të transferoheshin fizikisht në posedim të kërkuarit. Gjykata vlerëson se kjo deklaratë nuk mbështetet me prova, veçanërisht nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Pogradec, e cila në lëshimin e një urdhri ekzekutimi në favor të kërkuarit i referohej qartë së drejtës së tij për të zotëruar dhe për të disponuar parcelat në fjalë (shihni paragrafin 14 më sipër). ZRPP-ja, e cila ishte palë në proces (shihni paragrafin 8 më sipër), ishte mbështetur në një rregullore të brendshme për të justifikuar refuzimin e saj, si organ administrativ, për të zbatuar udhëzimet e qarta të gjykatës përkatëse për të vijuar me regjistrimin e titullit të kërkuarit.

26. Prandaj, Gjykata konstaton se autoritetet vendëse nuk arritën të bënin të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbatuar vendimet e brendshme përfundimtare në favor të kërkuarit. Prandaj, ankimet e kërkuarit për këtë qëllim janë të pranueshme. Gjykata konkludon, gjithashtu, se ka pasur shkelje të drejtave të kërkuarit, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

## II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

27. Duke pasur parasysh dokumentet që dispononte dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Qufaj Co. sh.p.k.*, cituar më sipër, §§ 46–48 dhe *Gjyli*, gjithashtu të cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata e konsideron të arsyeshme dhënien e shumës së treguar në tabelën e bashkëngjitur.

28. Gjykata vëren më tej, se Shteti i paditur ka një detyrim të papërmbushur për të zbatuar vendimin e vitit 2006, të ndryshuar nga vendimi i vitit 2008.

### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Vendos* që z. Ferdinand Tona, trashëgimtari i kërkuarit, legjitimohet të vazhdojë këtë proces në vend të tij.

2. *Shpall* të pranueshëm ankimin e kërkuarit në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të brendshme përfundimtare në favor të tij.

3. *Vendos* që është shkelur paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës sa i përket mosekzekutimit nga ana e autoriteteve të vendimeve të brendshme përfundimtare në favor të kërkuarit.

4. *Vendos* që Shteti i paditur, me anë të mjeteve të duhura, brenda tre muajve, të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të brendshme përfundimtare në fjalë, siç përshkruhet në tabelën bashkëngjitur.

5. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur t'i paguajë trashëgimtarit të kërkuarit, z. Ferdinand Tona, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohet në monedhën e Shtetit të paditur me normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumën e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2024, sipas rregullës 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Viktoria Maradudina**                      **Peeter Roosma**  
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË      PRESIDENT

### SHTOJÇË

Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës  
(mosekzekutimi ose ekzekutimi me vonesë i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendlindja e përfaqësuesit	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Detajet e urdhrimit të ekzekutimit	Shuma e caktuar për dëmin jopasuror, dhe kosto dhe shpenzime (në euro) <sup>1</sup>
78957/11 1.12.2011	<b>Llazi Tona</b> Lindur më 1939- n dhe vdekur në dhjetor 2017  <b>Ferdinand Tona</b> 1963	Theodhosi Afërdita Tiranë	Vendimi i Komisionit të Korçës i 4 korrikut 2006, i ndryshuar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Pogradec të 14 nëntorit 2008	Vendimi i Gjykatës të Rrethit Pogradec i 30 dhjetorit 2010	4.700

<sup>1</sup>Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.